Plagosi me armë gjahu 49-vjeçarin në Kurbin pas konfliktit banal, lokalizohet dhe kapet autori (EMRI)

11 Mars, 2023 16:01

Madhësia e tekstit:

Policia e Kurbinit ka arrestuar një 56-vjeçar i cili dyshohet se ka plagosur me armë zjarri më 7 mars në Patok shtetasin Besnik Pula pas një konflikti verbal mes të dyve.

Mësohet se i arrestuari Besnik Selmani e plagosi atë me një armë zjarri çifte dhe më pas është larguar nga vendngjarja dhe është lokalizuar sot.

Njoftimi i policisë:

Kurbin / Finalizohet operacioni policor "Laguna" mbi dokumentimin e plotë të ngjarjes së ndodhur datë 7 Mars në Patok, ku mbeti i plagosur shtetasi B. P.

Lokalizohet dhe vihet në pranga në një banesë të braktisur, 56-vjeçari autor i dyshuar.

Policia i gjen dhe sekuestron armën e gjahut çifte të dyshuar të përdorur në ngjarje.

Me datë 07.03.2023, në Lagunën e Patokut, Kurbin, shtetasi B. S. 56 vjeç, banues në Milot, pas një konflikti të çastit për motive të dobëta, dyshohet që ka plagosur me armë gjahu çifte shtetasin B. P. 49 vjeç, banues në Krujë, i cili pas mjekimit në spital, ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Menjëherë pas ngjarjes, shërbimet policore të Komisariatit të Policisë Kurbin, kanë shpallur në kërkim policor si dhe kanë vazhduar kontrollet e pandërprera duke vlerësuar e verifikuar edhe çdo informacion policor të administruar mbi vendndodhjen e autorit të dyshuar, me qëllim kapjen dhe vendosjen e tij përpara përgjegjësisë ligjore penale.

Si rezultat, gjatë ditës së sotme, është finalizuar operacioni policor i koduar "Laguna", ku u bë e mundur lokalizimi dhe kapja e shtetasit B. S. në një banesë të braktisur në fshatin Fushë Milot, Kurbin, ku ishte fshehur e strehuar.

Gjithashtu, në momentin e kapjes, iu gjet e sekuestruar në cilësinë e provës materiale arma e gjahut çifte, e dyshuar e përdorur ditën e ngjarjes, të cilën e kishte të regjistruar me leje përkatëse në emër të tij.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Kurbin për veprat penale " Vrasje me dashje' mbetur në tentativë" dhe "Prodhimi e mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

Njësi viktimë dhe tre të plagosur pas të shtënave me armë në Tiranë, një fëmijë plagoset në këmbë
12 Mars, 2023

Njësi viktimë dhe tre të plagosur pas të shtënave me armë në Tiranë, 'shënjestra' një prej të plagosurve, gazetari: Dyshohet për një atentat
12 Mars, 2023

Taboola Feed

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
No Install. Play for free.
Mave Battle | Sponsored
Play Now

Incredible: seniors are snapping up these new slippers, here's the reason!
OrthoCare | Sponsored


"Mos u shqetëso kur i jap me një dorë makinës, por kur i përdor të dyja", aksidenti horror te Mbikalimi i Saukut, i riu me shpejtësi 270 km/h, ja videot...
"Mos u shqetëso kur i jap me një dorë makinës, por kur i përdor të dyja", aksidenti horror te Mbikalimi i Saukut, i riu me shpejtësi 270 km/h, ja videot që postonte
balkanweb.com


Here's What Liposuction In Mexico Might Cost You!
Liposuction Cost | Sponsored

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Tre të plagosur dhe një viktimë pas të shtënave me armë në Tiranë, gazetari jep detaje: Janë sekuestruar kamerat të sigurisë
12 Mars, 2023

Njësi viktimë pas të shtënave me armë në një lokal në Tiranë, ja pamjet nga vendi i ngjarjes
12 Mars, 2023

Të shtënat me armë zjarri në një lokal në Tiranë, humb jetën një grua
12 Mars, 2023

Pas Fierit një tjetër aksident në Sarandë/ Përplasen 2 automjete në hyrje të qytetit, plagosen 2 shoferët
12 Mars, 2023

Ishin në Karaburun me guidë, turistja humb kontaktet me grupin për shkak të mjegullës
12 Mars, 2023

VIDEO/ Aksident në Fier, makina fshehet plotësisht, shofer transportohet në spital
12 Mars, 2023

KATEGORIA VIDEO

Njësi viktimë dhe tre të plagosur pas të shtënave me armë në Tiranë, 'shënjestra' një prej të plagosurve, gazetari: Dyshohet për një atentat
12 Mars, 2023

Tre të plagosur dhe një viktimë pas të shtënave me armë në Tiranë, gazetari jep detaje: Janë sekuestruar kamerat të sigurisë
12 Mars, 2023

Njësi viktimë pas të shtënave me armë në një lokal në Tiranë, ja pamjet nga vendi i ngjarjes
12 Mars, 2023

Të shtënat me armë zjarri në një lokal në Tiranë, humb jetën një grua
12 Mars, 2023

Ironia e fatit, kërkesa e Berishës për t'u regjistruar me emrin e PD-së në ngjeshjet e 14 majit ni dorë të Ish zv.kryeministrit të tij, Ilir Rusmali
12 Mars, 2023

"Tigrat e Belindës u kushtojnë shqiptarëve 64 milionë dollarë", Berisha: Solli anëjet nga Bangladeshi, sot çmimi i prodhimit të energjisë është në lëvë në bursë
12 Mars, 2023

BW | Download on App Store | GET IT ON Google Play

Kërko ketu

LAJMET E FUNDIT

Njësi viktimë dhe tre të plagosur pas të shtënave me armë në Tiranë, një fëmijë plagoset në këmbë
12 Mars, 2023

Njësi viktimë dhe tre të plagosur pas të shtënave me armë në Tiranë, 'shënjestra' një prej të plagosurve, gazetari: Dyshohet për një atentat
12 Mars, 2023

Tre të plagosur dhe një viktimë pas të shtënave me armë në Tiranë, gazetari jep detaje: Janë sekuestruar kamerat të sigurisë
12 Mars, 2023

Njësi viktimë pas të shtënave me armë në një lokal në Tiranë, ja pamjet nga vendi i ngjarjes
12 Mars, 2023

Të shtënat me armë zjarri në një lokal në Tiranë, humb jetën një grua
12 Mars, 2023

Rikthehet Kupa e Shqipërisë, ja kur do të zhvillohen ndeshjet e kthimit
12 Mars, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.